



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATËVE NGA LISTAT SHUMEMËRORE PËR KËSHILLAT BASHKIAK NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 19.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

**OBJEKT:** Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listave shumëmemërore për këshillat bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet për qeverisjen vendore të datës 30 qershor 2019.

**BAZË LIGJORE:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Neni 10, pika 1, germa "a" i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



**Nr . 565 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

## VËREN

Partia Ora e Shqipërisë, pjesëtare e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të kandidatëve për këshillin e bashkisë Kukës, Bulqizë, Sarandë, Klos dhe Kurbin, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumëmemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, rezulton se asnjë prej kandidatëve nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në përgjigje të shkresës, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në KQZ, verifikim i gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak Kukës, Bulqizë, Sarandë, Klos dhe Kurbin sipas të cilës rezulton:

**XHEVDET SOPAJ** kandidat i regjistruar në listën shumëmemërore Partia Ora e Shqipërisë me numër rendor 07, Bashkia Kukës ka deklaruar dënime në formularin e vetëdeklarimit. Sipas shkresës nr.3677 prot, dt.16.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore nr. v-1517/1, datë 17.05.2019, rezulton me vendimin nr.93, datë 27.10.1998 Gjykata e Rrethit Kukës e deklaroi fajtor për veprën penale "Lidhje pa leje në rrjetin e ujësjellësit" parashikuar nga neni 159/2 i K.Penal dhe po në bazë të kësaj dispozite e dënon me 2 (dy) muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të K.Penal pezullon ekzekutimin e vendimit dhe vihet në provë për 2 (dy) vjet kohë me kusht. Z. Xhevdet Sopaj për këtë vepër penale është rehabilituar sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Në bazë të vendimit nr.105, datë 07.11.2012 Gjykata e Rrethit Kukës e deklaroi fajtor për veprat penale "Prodhim dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake" "Prodhim dhe mbajtja pa leje të municioneve" dhe në bazë të nenit 278/2, 278/3 i K.Penal dhe nenit 406 të K.Pr.Penale është dënuar me 4 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të K.Penal pezullon ekzekutimin e vendimit dhe



### **Nr . 565 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

vihet në provë për 18 (tetëmbëdhjetë) muaj me kusht. Z. Xhevdet Sopaj për këtë vepër penale është rehabilituar sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Në bazë të vendimit nr.220, datë 13.07.2017 Gjykata e Rrethit Kukës e deklaroi fajtor për veprat penale "Falsifikimi të vulave, stampave ose formularëve" dhe në bazë të nenit 190/1 i K.Penal dhe nenit 406 të K.Pr.Penale është dënuar me 4 muaj burgim. Në aplikim të nenit 63 të K.Penal pezullon ekzekutimin e dënimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me punë në interes publik.

**XHELAL HOXHA** kandidat i regjistruar në listën shumëmemërore Partia Ora e Shqipërisë me numër rendor 08, Bashkia Klos. Sipas shkresës nr.3762 prot, dt.17.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjëndjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të Gjëndjes Gjyqësore nr. v-1562/1, datë 17.05.2019, rezulton me vendimin nr.08, datë 21.11.2007 Gjykata e Rrethit Dibër e deklaroi fajtor për veprën penale "Prerje e paligjshme e pyjeve" e në bazë të nenit 205 të K.Penal e dënon me 100 000 lekë gjobë. Z. Xhelal Hoxha për këtë vepër penale është rehabilituar sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Sipas nenit 4, pika 9 të ligjit të sipërcituar .....

Ulja e masës së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit, amnistia, depenalizimi, falja, pezullimi i dënimit, lirimi i parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim i dënimit, në përputhje me ligjin, nuk ndikojnë në zbatimin e këtij ligji dhe nuk përllogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj. Ky ligj nuk zbatohet për dënime të dhëna për dispozita që janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese pas dhënies së dënimit përkatës, si dispozita në kundërshtim me Kushtetutën në fuqi në momentin e dënimit.

Referuar nenit 406 të K.Pr.Penale .....

**Kur jep vendim dënimi, gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën.** Në bazë të vendimit nr.220, datë 13.07.2017 Gjykata e Rrethit Kukës z. Xhevdet Sopaj është deklaruar fajtor për veprat penale "Falsifikimi të vulave, stampave ose formularëve" dhe në bazë të nenit 190/1 i K.Penal dhe nenit 406 të K.Pr.Penale është dënuar me 4 muaj burgim. Në aplikim të nenit 63 të K.Penal pezullon ekzekutimin e dënimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me punë në interes publik. Sipas përllogaritjes dënimi pa marrë parasysh uljen e tij bazuar në nenin 406 të K.Pr.penale ka qënë 6 muaj burgim.

Referuar gurmës ç, të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët kryejnë me dashje një krim që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, dhe kur janë dënuar **me jo më pak se 6 muaj burgim.**

Ligji nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.



## **Nr . 565 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Sipas nenit 4, pika 4 të ligjit të sipërcituar .....

Për personat që parashikohen nga shkronja "ç", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Referuar nenit 69 të Kodit Penal .....

**Quhen të padënuar: a) ata që janë dënuar me burgim për një kohë gjer në gjashtë muaj ose me çdo dënim tjetër më të lehtë dhe që gjatë dy vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale;**

Referuar të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga z. **Xhevdet Sopaj kandidat me numër rendor 07, për anëtar këshilli i Bashkisë Kukës**, vërtetimit të gjendjes gjyqësore në lidhje me veprën penale, "Fallsifikimi të vulave, stampave ose formularëve", parashikuar nga neni 190/1 i K.Penal, nr.220, datë 13.07.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, z. Xhevdet Sopaj për kryerjen e kësaj vepre penale është brenda periudhës së ndalimit për zgjedhjen në funksionin, kandidat për këshilltar i këshillit të bashkisë Kukës.

Për sa më sipër duke qene se kushtet për ndalim janë verifikuar para procesit të pranimit të kandidaturave, referuar nenit 10 pika 1, germa "a" të ligjit 138/2015, KQZ duhet të refuzoj kandidaturën e z. **Xhevdet Sopaj** dhe t'i kërkoj subjektit zgjedhor Parta Ora e Shqipërisë të zëvendësojë kandidaturën brenda afatit të parashikuar për dorëzimin e kandidaturave.

Për sa më sipër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 10, pika 1, germa "a" e Ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" shpall faktin se z. Xhevdet Sopaj është në kushtet e moszgjedhshmërisë si kandidat për anëtar Këshilli të Bashkisë Kukës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Referuar nenit 33, germa "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe pikës 5/1, 6 të nenit 9 të udhëzimit nr.2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve", KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për regjistrimin e listës shumemërore për këshillin e Bashkisë Kukës, Bulqizë, Sarandë, Klos dhe Kurbin, të Partisë Ora e Shqipërisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

## PËR KËTO ARSYE:



**Nr . 565 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Neni 10, pika 1, germa "a" dhe neni 11 i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

#### **VENDOSI:**

1. Të refuzojë kandidaturën e z. Xhevdet Sopaj për këshillin e bashkisë Kukës, Partia Ora e Shqipërisë.
2. Njoftimin e Partisë Ora e Shqipërisë të zëvendësojë kandidaturën brenda afatit të parashikuar për dorëzimin e kandidatëve.
3. Njoftimin e KZAZ-ve nr. 11, nr. 15, nr. 17, nr. 18, nr. 88 për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e listës shumëmemërore për këshillat bashkiak në bashkitë Kukës, Bulqizë, Sarandë, Klos dhe Kurbin, të Partisë Ora e Shqipërisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes bashkëlidhur.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr . 565 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.